



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË SHKODËR, QARKU SHKODËR, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT:

Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019.

BAZË LIGJORE:

Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Zona Zgjedhore Bashkia Shkodër territori i saj është i ndarë në 4 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja vërrifikon dhe nxjerr rezultatit për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Këshillin e Bashkisë Shkodër nga të 4 KZAZ-të e kësaj bashkie, KQZ, nxjerr rezultatit për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.



Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për këshill të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuar nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.2, KZAZ nr.3, KZAZ nr.4, KZAZ nr.5 dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.02, nuk përfshin rezultatin e votimit të QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345.

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.03, KZAZ nr.04, KZAZ nr.05 përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.

- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

Nr.	QV	ZAZ 5 Shkodër / Këshill	GN	TPR	SISTEMI
1	0307	Nr. i votuesve Femra	19	29	29
2	0313	Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	0	3	3
3	0313	Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	3	1	1
4	0313	Partia Socialiste e Moderuar	1	10	10
5	0313	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	10	34	34
6	0313	Partia Socialiste e Shqipërisë	34	1	1
7	0313	Partia Bindja Demokratike	1	0	0

Nga verifikimi i dokumentacionit të KZAZ nr. 02, Librit të Protokollit të Mbledhjeve rezulton se në QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345, në datë 30 Qershor 2019, votimi nuk është zhvilluar.

KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, me shifrat e korigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj Bashkie, të plotësuar nga grupi i numërimit të votave përvec QV nr. 0077; QV nr. 00771; QV nr. 00791; QV nr. 0082; QV nr. 0083; QV nr. 0086; QV nr. 00861; QV nr.0224 ; QV nr. 0345.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" dhe nenin 123, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,



V E N D O S I:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

